Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 17 gusht 2012

Lëndët me nr. 32/08, Bozhidarka FELEGI; 05/09, Dragan PILJEVIÇ; 203/09, Svetlana MARINKOVIÇ; 310/09, Velibor AXHANÇIÇ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 17 gusht 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesave të sipërpërmendura, të paraqitura në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, bëri konstatimet dhe rekomandimet vijues e:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa e znj. Bozhidarka Felegi (lënda nr. 32/08) u paraqit më 30 qershor 2008 dhe u regjistrua më 18 korrik 2008. Ankesa e z. Dragan Piljeviç (lënda nr. 05/09) u paraqit më 3 dhjetor 2008 dhe u regjistrua më 21 janar 2009 2009, ankesa e znj. Svetlana Marinkoviç u paraqit më 30 prill 2009 dhe u regjistrua në datën e njëjtë dhe ankesa e z. Velibor Axhançiç (lënda nr. 310/09) u paraqit më 18 shtator 2009 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Me vendimet e 16 dhjetorit 2011, Paneli i shpall ankesat në rastet e z. Dragan Piljeviç (lënda nr. 05/09) dhe z. Velibor Axhançiç (lënda nr. 310/09) të pranueshme pjesërisht.

3. Më 5 mars 2012, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i paraqiti komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e ankesave të zotërinjve Pilieviç dhe Axhançiç.

4. Me vendimin e 20 janarit 2012, Paneli e shpalli ankesën për rastin e znj. Bozhidarka Felegi (lënda nr. 32/08) të pranueshme pjesërisht.

5. Më 12 mars 2012, PSSP-ja i paraqiti komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e kësaj ankese.

6. Me vendimin e 16 marsit 2012, Paneli e shpalli ankesën për rastin e znj. Svetlana Marinkoviç (lënda nr. 203/09) të pranueshme pjesërisht.

7. Më 23 April 2012, PSSP-ja paraqiti komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e kësaj ankese.

II. FAKTET

8. Znj. Felegi, znj. Marinkoviç dhe z. Piljeviç janë ish banorë të Kosovës të cilët aktualisht jetojnë në territorin e Serbisë, kurse z. Axhançiç vazhdon të jetojë në Kosovë. Të gjithë ankuesit ishin pronarë të pasurisë së paluajtshme në Kosovë. Ata jetuan aty deri në vitin 1999 kur ata duhej të largoheshin nga ajo pronë. Më vonë, ata të gjithë kuptuan se pronat e tyre ishin dëmtuar apo shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

9. Ankuesit parashtruan kërkesa duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar pronës së tyre pranë gjykatave kompetente komunale. Znj. Felegi dhe z. Piljeviç i drejtuan ankesat e tyre kundër UNMIK-ut, KFOR-it, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) dhe komunave përkatëse. Znj. Marinkoviç dhe z. Axhançiç i drejtuan ankesat e tyre kundër komunave përkatëse dhe IPVQ-ve. Të gjitha ankesat u parashtruan në vitin 2004.

10. Përafërsisht 17,000 kërkesa për kompensim u parashtruan në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës, numri më i madh i të cilave nga serbët e Kosovës, të cilët për shkak të luftës ishin larguar nga shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar apo shkatërruar. Me synimin për të përmbushur kufizimin kohor prej pesë vitesh për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i paraqitën kërkesat e tyre përafërsisht në kohën e njëjtë në vitin 2004. Këto ankesa ishin drejtuar kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Milogoriç dhe të Tjerët*, lëndët me nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, në § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit e bazuan ankesën e tyre, shih mendimin e njëjtë, në § 5).

11. Sa u përket këtyre rasteve, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut në Kosovë më 26 gusht 2004. Në këtë shkresë, Drejtori i DD theksoi se janë parashtruar "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemeve të cilat një fluks kaq i madh i kërkesave do të paraqiste për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë lëndë e [tillë] të mos caktohej për shqyrtim derisa ne bashkërisht të kemi vendosur se si më së miri të bëjmë procedimin e këtyre rasteve" (për tekstin e

plotë të shkresës, shih mendimin për *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 10 lart, në § 6).

12. Më 15 nëntor 2005, DD u bëri thirrje gjykatave të fillojnë procedimin e kërkesave për kompensim të dëmit të shkaktuar nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar se më nuk ekzistonin "pengesat për procedimin efikas të këtyre lëndëve". Ankesat/kërkesat që lidheshin me ngjarjet që u paraqitën para tetorit 2000 nuk u ndikuan nga kjo shkresë.

13. Më 28 shtator 2008, Drejtori i DD i informoi gjykatat që tani të procedohen rastet të cilat nuk ishin caktuar për shqyrtim sipas kërkesës së 26 gushtit të vitit 2004.

14. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

15. Kah fundi i vitit 2008, gjykatat nuk i kishin kontaktuar ankuesit dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore.

16. Rrethanat e rasteve individuale në fjalë janë paraqitur në shtojcën e këtij mendimi.

III. ANKESAT

17. Përderisa ankesat janë shpallur të pranueshme, ankuesit në esencë pohojnë se procedura lidhur me kërkesat e tyre për kompensim të pronës së dëmtuar ishin pezulluar, duke e bërë kështu të pamundshme për ata të marrin vendim për kërkesat e tyre, duke shkelur të drejtën e tyre për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ata po ashtu ankohen se, si pasojë e pezullimit, procedura nuk është përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Më në fund, ata pohojnë se për arsyen e njëjtë është shkelur edhe e drejta e tyre për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ.

IV. BASHKIMI I ANKESAVE

18. Paneli, në pajtim me Rregullën 20 të Rregullores së vet të punës, vendos të bashkojë të katër ankesat.

V. LIGJI

Pohimi për shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ

19. Paneli thekson se rastet e ankuesve ngrenë çështje thelbi i të cilave tanimë i është paraqitur Panelit nga ankues të tjerë. Paneli përkujton se në rastet e bashkuara *Milogoriç dhe të Tjerët* (cituar në § 10 lart) për shembull, ai shqyrtoi rastet e pesë

ankuesve të cilët po ashtu ishin pronarë të pasurisë së paluajtshme në Kosovë. Në vitin 1999, duke u frikësuar nga lufta, ata gjithashtu u larguan nga shtëpitë e tyre në Kosovë. Pronat e tyre ishin dëmtuar apo shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999, pas hyrjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Këta ankues po ashtu parashtruan ankesa në vitin 2004 pranë gjykatave kompetente komunale kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave përkatëse, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar pronës së tyre. As ata nuk ishin kontaktuar nga gjykatat dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore, për shkak të intervenimit të sipërpërmendur nga DD, që ndaloi procedurat gjyqësore nga gushti i vitit 2004 deri në shtator 2008. Në këto raste, Paneli konkludoi se ishin shkelur të drejtat e ankuesve për të marrë vendim për ankesat e tyre nga gjykata.

20. Paneli thekson se PSSP-ja nuk dha komente për bazueshmërinë e ankesës së znj. Marinkoviç (lënda nr. 203/09). Në vend të kësaj, në përgjigjen e tij PSSP-ja argumentoi se fakti se ankuesja e parashtroi ankesën e saj në gjykatën komunale të Suharekës nuk ka dëshmi.

21. Paneli kërkoi nga Zyra ndërlidhëse e gjykatës (ZNGJ) në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës të konfirmojnë këtë fakt. ZNGJ u përgjigj se ankesa e ankueses është e regjistruar në arkivin e tyre me numrin 106/SR. Sipas shënimeve të ZNGJ, ankesa ishte parashtruar në gjykatën komunale të Suharekës nga zyrtarët e ZNGJ në emër të ankueses më 12 gusht 2004. Në regjistrin e gjykatës ankesa u regjistrua me numrin P.Br. 153/04. Prandaj, Paneli e hedh poshtë këtë vërejtje të PSSP-së dhe vazhdon me shqyrtimin e rastit për bazueshmërinë e tij.

22. Në përgjigjet e tij për tri ankesat tjera, PSSP-ja paraqet argumente të detajuara, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në mes tjerash, PSSP-ja argumenton se kërkesa e UNMIK-ut që të pezullohet procedura duhet të konsiderohet se ka pasur një qëllim legjitim, dhe se në rrethanat e Kosovës pas konfliktit dhe me sistemin e saj të posa-zhvilluar gjyqësor, pezullimi i përkohshëm ishte mënyra e vetme për UNMIK-un që të merret me situatën e jashtëzakonshme me të cilën përballej sistemi gjyqësor i Kosovës, të shkaktuar nga fluksi i kërkesave për kompensim. PSSP-ja gjithashtu argumenton se ekzistonte një proporcion i arsyeshëm në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohej të arrihej, sepse ishte bërë një kompromis i drejtë në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave fundamentale të individëve. Sipas PSSP-së arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet vlerësuar nga pikëpamja e rrethanave të caktuara të rastit, dhe Gjykata Evropiane, në veçanti, zbaton tri kritere: sjelljen e autoriteteve gjyqësore, ndërlikueshmërinë e rastit, dhe sjelljen e aplikantit. Vetëm vonesat të cilat i atribuohen shtetit përbëjnë shkelje të kushtit për kohë të arsyeshme. PSSP-ja analizon në detaje zbatimin e tri kritereve të lartcekura në kontekstin e Kosovës dhe ashtu si ata ndërlidhen me ankuesit.

23. Sa i përket sjelljes së ankuesve, PSSP-ja argumenton se ata nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi për të treguar se ata në ndonjë mënyrë janë interesuar ndonjëherë për progresin e arritur në rastet e tyre, apo se janë ankuar që për lëndët e tyre nuk është bërë progres dhe se duhet bërë progres qoftë brenda gjykatave vendore në Kosovë ose në DD, apo në ndonjë organ tjetër të IPVQ-ve apo në UNMIK, duke përfshirë edhe zyrat ndërlidhëse të gjykatave. Ankuesit as nuk i janë ankuar EULEX-it pas vendosjes së tij në Kosovë në dhjetor 2008.

24. Paneli përkujton se tashmë ka shqyrtuar dhe ka hedhur poshtë të gjitha këto argumente në rastet *Milogoriç dhe të Tjerët* (cituar në § 10 lart), në *Berisha dhe të Tjerët* (HRAP, lëndët me nr. 27/08 dhe të tjerat, mendim i 23 shkurtit 2011, § 24) dhe në *Laliç dhe të Tjerët* (HRAP, *lëndët me nr*. 30/08 dhe të tjerat, mendim i 13 majit 2011, § 21). Sa i përket argumentit se duhet të merren parasysh rrethanat në Kosovë, Paneli konstatoi se qëndron fakti se karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e lidhura me këtë duhet të merren parasysh lidhur me një numër të rasteve, por nën asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për zvogëlimin e nivelit të standardeve të të drejtave të njeriut, të cilat janë inkorporuar sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (*Milogoriç dhe të Tjerët*, § 44; *Berisha dhe të Tjerët*, § 25; *Laliç dhe të Tjerët*, § 22).

25. Paneli nuk sheh ndonjë arsye që t'ju shmanget këtyre konstatimeve.

26. Sa i përket argumentit të PSSP-së se ankuesit nuk kanë kërkuar të kuptojnë për progresin e rasteve të tyre në gjykatat përkatëse, qoftë para vendosjes së EULEX-it në dhjetor 2008 apo pas kësaj, Paneli tashmë i ka hedhur poshtë këto argumente në rastin *Laliç dhe të Tjerët* (cituar në § 24 lart). Ai konstatoi se ankuesit nuk mund të fajësoheshin për faktin se nuk kanë kërkuar informacione në gjykatat përkatëse lidhur me progresin e bërë në rastet e tyre (*Laliç dhe të Tjerët*, § 25). Për më tepër, lidhur me argumentin se ankuesit nuk kërkuan informacione nga EULEX-i për progresin e rasteve të tyre, Paneli ka konstatuar se kjo çështje ishte jorelevante për shqyrtimin e ankesave, meqë situata pas dhjetorit 2008, sido që të jetë, është jashtë përgjegjësisë së UNMIK-ut (shih § 14 lart; *Laliç dhe të Tjerët*, § 26).

27. As këtyre konstatimeve Paneli nuk sheh arsye që t'ju shmanget.

28. Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ lidhur me pamundësinë e ankuesve që ankesat e tyre të vendosen nga gjykatat, dhe se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ndarazi çështja e kohëzgjatjes së procedurës.

Pohimi për shkelje të nenit 13 të KEDNJ

29. Paneli konstaton se ankesat sipas nenit 13 të KEDNJ (e drejta për mjet të efektshëm) kanë të bëjnë në esencë me çështjet e njëjta sikurse ato të trajtuara në nenin 6 § 1. Në këto rrethana, Paneli konstaton se nuk janë ngritur çështje të veçanta sipas nenit 13 të KEDNJ (HRAP, *Milogoriç dhe të Tjerët*, cituar në § 10 lart, në § 49).

V. REKOMANDIMET

30. Duke u bazuar në konstatimet e Panelit për këtë rast, Paneli mendon se ndonjë formë e shpërblimit është e nevojshme.

31. UNMIK-ut natyrisht i takon të ndërmerr masat e duhura për t'i dhënë fund shkeljes së theksuar dhe për të kompensuar për aq sa është e mundshme efektet e saj. Mirëpo, siç theksoi Paneli më lart (shih § 14) përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga EULEX-i në fushën e sundimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u

nuk është më në gjendje të ndërmerr masa të cilat do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në procedurat që janë në pritje pranë gjykatave komunale.

32. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi që të kompensojë aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për situatat me juridiksion të reduktuar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion përballë autoriteteve të Kosovës, për të marrë garanci se lëndët e paraqitura nga ankuesit do të procedohen sipas rregullit (shih HRAP, *Milogoriç dhe të Tjerët* § 49, dhe *Laliç dhe të Tjerët* § 32, cituar lart; krahaso Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Ilashcu dhe të Tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykim i 8 korrikut 2004, KEDNJ, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i 2 marsit 2010, § 171).

33. Paneli po ashtu konsideron se UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapat e duhur për kompensim adekuat për secilin ankues për dëme jomonetare që i kanë pësuar si pasojë e pezullimit të gjatë të procedurës së iniciuar nga ata.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME PAMUNDËSINË E ANKUESVE QË ANKESAT E TYRE TË VENDOSEN NGA GJYKATAT;

2. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHEN ANKESAT SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS;

3. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHEN ANKESAT SIPAS NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

4. REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. TË NXISË AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË TË NDËRMARRIN TË GJITHA HAPAT E MUNDSHËM PËR TË SIGURUAR QË RASTET E ANKUESVE TË VENDOSEN PA NDONJË VONESË TË MËTEJSHME;

b. TË NDËRMARRË HAPAT E NEVOJSHËM PËR KOMPENSIMIN ADEKUAT PËR SECILIN ANKUES PËR DËME JOMONETARE;

c. TË NDËRMARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE TË EFEKTSHME PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË

INFORMOJË ANKUESIT DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME NË KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar

Shtojca

Lënda nr. 32/08, Bozhidarka FELEGI

1. Ankuesja është ish banore e Kosovës e cila aktualisht jeton në territorin e Serbisë.

2. Ajo është pronare e pasurisë në Gjakovë. Pas largimit të saj nga Kosova, ajo mësoi se pasuria e saj ishte uzurpuar dhe dëmtuar.

3. Më 12 gusht 2004, ankuesja parashtroi kërkesë në gjykatën komunale të Gjakovës kundër komunës së Gjakovës, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar banesës së saj. Ajo kërkon 20,000 euro kompensim për këtë dëm.

4. Kah fundi i 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesen dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 05/09, Dragan PILJEVIÇ

5. Ankuesi është ish banor i Kosovës i cili aktualisht jeton në territorin e Serbisë.

6. Ai ishte pronar i një parcele tokë dhe i një shtëpie banimi në Fushë Kosovë; ai jetoi në atë shtëpi me familjen e tij deri në vitin 1999. Pas largimit të tij, shtëpia ishte thyer dhe ishte plaçkitur gjatë vitit 1999 dhe 2000.

7. Më 21 korrik 2004 ankuesi parashtroi ankesë në gjykatën komunale të Prishtinës kundër IPVQ-ve, komunës së Fushë Kosovës, UNMIK-ut dhe KFOR-it, për kompensimin e dëmeve të pësuara në shkatërrimin e shtëpisë. Ai kërkon 60,000 euro kompensim për këtë dëm.

8. Kah fundi i vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 203/09, Svetlana MARINKOVIÇ

9. Ankuesja është ish banore e Kosovës e cila aktualisht jeton në territorin e Serbisë. Ajo është bashkëpronare e pasurisë së paluajtshme, e cila përfshin një parcelë tokë, një shtëpi banimi, objekte përreth dhe pemë, në fshatin Mushitishtë, komuna e Suharekës.

10. Pas largimit të saj me familjen në qershor të vitit 1999, shtëpia, objektet përreth dhe pemët ishin plaçkitur dhe dëmtuar, për të cilat ankuesja mësoi në vitin 2003.

11. Më 12 gusht 2004, ankuesja parashtroi padi në gjykatën komunale të Suharekës kundër komunës së Suharekës dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar. Ajo kërkon 730,000 euro kompensim për këtë dëm.

12. Kah fundi i vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesen dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

13. Ankuesi është banor i Kosovës.

14. Më 5 gusht 2004, nëna e ankuesit parashtroi padi në gjykatën komunale të Prishtinës kundër komunës së Obiliqit dhe IPVQ-ve, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e shtëpisë së saj dhe objekteve përreth në fshatin Babi Most. Ajo kërkon 600,000 euro kompensim për këtë dëm.

15. Më 8 shtator 2004, nëna e ankuesit vdiq. Ankuesi u bë pronar i pasurisë që është objekt i padisë së sipërpërmendur.

16. Kah fundi i vitit 2008, gjykata komunale e Prishtinës nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore lidhur me kërkesën e tij.